



Agjencia Kosovare e Pronës

Buletini no. 5

Dhjetor 2006

KPA-ja nisë fushatën mediale jashtë Kosovës



**Qiratë e para janë transferuar sipas skemës mbi qiranë
6500 kërkesa janë paraqitur pranë KPA-së
KPA-ja është vendosur në zyret e reja qendrore
Si t'i bashkoheni skemës mbi qiranë?**

KPA-ja nisë fushatën mediale jashtë Kosovës



Me qëllim që t'i nxisë paraqitësit e mundshëm të kërkesave që të paraqiten si dhe të informojë publikun për mandatin, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, KPA-ja ka nisur fushatën mediale jashtë Kosovës më 22 nëntor. Fushata mediale do të zhvillohet në dy faza, e para do të përfundojë më 26 dhjetor. Faza e dytë do të nisë më 20 janar 2007 dhe do të vazhdojë deri më 6 mars 2007.

KPA-ja ndihet krenare me përfshirjen e Kryeministrit, z. Agim Çeku, në reklamën televizive si pjesë e fushatës. KPA-ja po ashtu dëshiron që t'i shprehë mirënjohje Qendrës për Koordinim të Kosovës (QKK) për ndihmën e dhënë në arritjen e zbritjes së konsiderueshme të çmimit për reklamim në Serbi.

Fushata mediale e KPA-së do të zhvillohet në mediat kombëtare dhe lokale në Mal të Zi, Serbi, Kosovë dhe IRJM.

Të gjitha reklamat e fushatës mediale do të mund të shihen në <http://www.kpaonline.org/sq/video.asp> pasi që ato janë duke u përgatitur.

Kosovo

RTK
TV21
TV MIR
TV Herc
TV Puls
Radio Kosova
Radio Dukagjin
Radio Gracnica
Kontakt Plus
Radio Max
Radio Borzani
Radio Gorazdevac
Koha Ditore
Zeri
Gazetta Express
Jedinstvo

Montenegro

RTV CG
Radio Elmag
Radio D
Radio Cme Gore
Radio Bar
Radio Berane
Radio Delfin
Montenegro Family

Serbia

RTS
TV Pink
TV5 Nis
RTV Kraljevo
TV Smederevo
RTV Kragujevac
Radio Kragujevac
Radio Kraljevo
Radio 5 Nis
Radio OK Vranje
Radio Smederevo
Radio Belleamie Nis
Radio Vihor Vranje
Politika
Novosti
Ibarske Novosti
Svetlost Kragujevac
Nas Glas Smederevo

6500 kërkesa janë paraqitur pranë KPA-së

Deri më tani 6590 kërkesa janë paraqitur në KPA.

Kërkesat që janë paraqitur në KPA përfshijnë kërkesat për:

439 prona banimi

463 prona komerciale

5688 prona bujqësore

Prej kërkesave të paraqitura, 1302 janë paraqitur në zyret e KPA-së në Kosovë dhe 4288 kërkesa janë paraqitur në zyret tona që gjenden në Serbi dhe Mal të Zi.

Numri i kërkesave është duke u rritur dita ditës dhe KPA-ja supozon të pranojë në përgjithësi më shumë se 11.000 kërkesa. "Të gjithë ata që kanë humbur posedimin mbi patundshmëritë e tyre private si rezultat i konfliktit të armatosur gjatë viteve 1998-99

duhet të paraqesin kërkesat e tyre zyreve të KPA-së sa më shpejt që është e mundur. Tani kemi filluar përpunimin e kërkesave që kemi pranuar dhe supozoj që vendimet e para të lëshohen në fillim të vitit të ardhshëm", thekson në një deklaratë Drejtori Ekzekutiv i KPA-së, Knut Rosandhaug.

Statistikat e përditësuara mbi kërkesat që i janë paraqitur KPA-së mund të gjenden në faqen e internetit:

Numri i përgjithshëm i pronave të kërkuara sipas komunës: <http://www.kpaonline.org/ClaimsTotal.asp>

Lloji i pronave të kërkuara sipas regionit:

<http://www.kpaonline.org/claimProp.asp>

Lloji i së drejtës pronësore të kërkuar sipas rajonit:

<http://www.kpaonline.org/claimProp.asp>

Rajoni	Të paraqitura	%
Në tërë Kosovën	6590	100
MITROVICË	811	12.3
Leosaviq	0	0
Mitrovicë	148	2.2
Skenderaj	397	6
Vushtrri	220	3.3
Zubin Potok	13	0.2
Zveqan	33	0.5
GJILAN	1010	15.3
Gjilan	98	1.5
Kamenicë	89	1.4
Kaçanik	46	0.7
Novobërdë	12	0.2
Ferizaj	487	7.4
Shtërpce	33	0.5
Viti	245	3.7
PEJË	2160	32.8
Gjakovë	99	1.5
Deçan	86	1.3
Klinë	487	7.4
Istog	963	14.6
Pejë	525	8
PRISHTINË	1533	23.3
Glllogoc	16	0.2
Fushë Kosovë	95	1.4
Lipjan	581	8.8
Obiliq	64	1
Podujevë	358	5.4
Prishtinë	378	5.7
Shtime	41	0.6
PRIZREN	1107	16.8
Dragash	5	0.1
Malishevë	14	0.2
Rahovec	55	0.8
Prizren	593	9
Suharekë	440	6.7

KPA-ja është zhvendosur në zyret e reja qendrore



Prej 12 dhjetorit KPA-ja është vendosur në zyret e reja qendrore në Prishtinë në (rr. Nazim Gafurri 1). Orari i punës do të mbetet prej 8.30-17.30.

Ju lutemi të keni parasyshë se zyra jonë që më parë gjendej në rrugën Vllazërim Bashkimi 51 është zhvendosur në zyrën qendrore të re. Zyra regjionale e KPA-së në Prishtinë si dhe administrata pronësore e KPA-së akoma gjenden në rrugën e Goleshit 2 / Rexhep Luci 28.

Detajet tona kontaktuese prej 12 dhjetorit 2006 janë:

Zyra Qendrore e KPA-së, Prishtinë
Nazim Gafurri 1
Telefoni: 038 518 307

Zyra Regjionale në Prishtinë
Rruga e Goleshit 2 / Rexhep Luci 28
Telefoni: 038 225 473

Skema mbi qiranë e KPA-së

Qiratë e para u janë transferuar bartësve të së drejtës pronësore sipas skemës mbi qiranë

Pagesat e para, të paguara sipas skemës mbi qiranë të KPA-së, janë pranuar këtë javë nga bartësit e së drejtës pronësore (BDP) që jetojnë në Kosovë dhe Serbi. Qiraja e parë e paguar nga qiraxhitë i është bartur 13 BDP-ve që jetojnë në Kosovë dhe 19 BDN-ve që jetojnë në Serbi.

Sipas rregulloreve të UNMIK-ut 2006/10 dhe 2006/50, KPA-së i është dhënë mandati për të mbikqyrur qiradhënien e pronave të braktisura në Kosovë. Së fundi, KPA-ja ka filluar me skemën mbi qiranë për pronat që janë nën administrim të saj. Kjo skemë mundëson që bartësit e së drejtës pronësore të marrin të ardhura të caktuara për pronën e tyre duke autorizuar KPA-në që të japë atë me qira derisa ai/ajo të vendosë për të shfrytëzuar pronën në ndonjë mënyrë tjetër.

Aktualisht nën administrim të KPA-së janë më shumë se 5000 prona. 765 prej këtyre pronave tani janë të përfshira në skemën mbi qiranë.

Për më shumë informata lidhur me skemën mbi qiranë, shiko artikullin tjetër në këtë raport të KPA-së apo vizito <http://www.kpaonline.org/rental/rentSQ/defaultSQ.asp>

Si t'i bashkoheni skemës mbi qiranë?

Të gjithë ata që kanë pronë nën administrim të KPA-së mund t'i bashkohen skemës mbi qiranë. Pjesëmarrja në skemën mbi qiranë është vullnetare dhe e thjeshtë. Bartësit e së drejtës pronësore (BDP) vetëm duhet të caktojnë një takim pranë një zyreje të KPA-së dhe të sjellin me vete:

1. Letërnjoftimin;
2. Udhëzimet e shkruara nga banka e BDP-së se si t'i pranohet pagesat elektronike nga banka në Kosovë
3. Adresën postare si dhe numrin e telefonit mobil të BDP-së dhe mundësisht adresën e postës elektronike.

Pa këto nuk mund të bëjmë procesimin e pagesave mbi qiranë.

Si do të pranohet qiraja?

Qiraja mund të pranohet vetëm nëse ekziston një qiraxhi për të marrë pronën me qira. Kështu që, KPA-ja nuk është në gjendje të garantojë pagesën - kjo tërësisht varet nga tregu i qirasë në vendin ku gjendet prona. Nëse prona nuk i është ndarë ndonjë qiraxhiu, BDP-ja nuk do të marrë ndonjë qira.

Shuma e qirasë është e përcaktuar nga KPA-ja në bazë të vlerës së tanishme të pronës të përcaktuar nga autoritetet publike. Megjithatë, shumën e qirasë nuk është e negociueshme as nga qiradhënësi e as nga qiramarrësi. BDP-ja mund ta ndërprejë qiranë e KPA-së në çdo kohë (shiko më poshtë) nëse ai/ajo beson se mund të arrijë shumë më të madhe të qirasë në tregun privat.

Qiraja grumbullohet nga KPA-ja për çdo muaj, pas një pagese fillestare të kaparit dhe qirasë për një muaj në avans. Nëse qiraja nuk paguhet, KPA-ja do ta dëbojë qiraxhiun. Kapari do të mbulojë qiranë potencialisht të papaguar apo do t'i kthehet qiraxhiut me rastin e ndërprerjes së marrëveshjes mbi qiranë.

Kush është qiraxhi?

Me përfshirjen në skemën mbi qiranë, BDP-ja e autorizon KPA-në që të gjejë një qiraxhi. KPA-ja do ta reklamojë pronën dhe do të arrijë një marrëveshje mbi qiranë me qiraxhiun e zgjedhur nga ne.

Si të ndërpritet marrëveshja mbi qiranë dhe të dilet nga skema mbi qiranë?

BDP-ja mund ta ndërprejë marrëveshjen mbi qiranë kurdoqoftë përmes një njoftimi me shkrim dërguar KPA-së. Përmes një udhëzimi të tillë, agjencia do të njoftojë qiraxhiun e tanishëm dhe do t'i kryejë llogaritë. Ky proces mund të zgjasë deri në tre muaj.

Sa do të mund të kush-tonin shërbimet e ofruara nga KPA-ja?

KPA-ja merr një tarifë nga qiraja mujore deri në 5% për të mbuluar shpenzimet administrative të shërbimeve mbi qiranë të ofruara bartësit të së drejtës pronësore. Në vazhdim, shpenzimet e tjera lidhur me pronën (siç janë sigurimi dhe tatimi) mund të mirren në pajtim me ligjet në fuqi.

Ju lutemi keni parasysh se ekziston një tarifë e caktuar nga bankat private për bartjen e të hollave në llogaritë bankare të BDP-ve. Brenda Kosovës tarifat janë të ulëta, megjithatë nëse BDP-të kërkojnë që qiraja e grumbulluar të bartet në llogaritë bankare jashtë Kosovës, tarifatat mund të jenë të larta deri në 15 € për transaksion.

Ju lutemi keni parasyshë:

KPA-ja nuk garanton ndonjë të ardhur nga prona. Nëse prona nuk është dhënë me qira, nuk mund të priten të ardhura.

Nëse qiraxhiu nuk paguan, atëherë kurrëfarë pagese nuk do të transferohet, por KPA-ja do të bëjë dëbimin nga prona dhe do t'ia ndajë atë një qiraxhiu të ri, i cili do të pranonte të paguante qiranë.

KPA-ja nuk merr përgjegjësinë për ndonjë dëm ndaj pronës në rast të një procesi të tillë të dëbimit. Nëse gjatë procesit prona është lënë e pabanueshme, KPA-ja do t'ia kthejë BDP-së posedimin e pronës.

*Ju urojmë Vitin e Ri dhe pushime të
këndshme!*

Agjencia Kosovare e Pronës



Agjencia Kosovare e Pronës

Zyret Qendrore të KPA-së

administrator@hpdkosovo.org
Nazim Gafurri 1, Prishtinë
Telefoni: +381 (0)38 518 307
Telefaksi: 038 249 919

Beograd

Kosovës 49/8
Telefoni: 011 334 5513
Telefaksi: 011 334 5314

Gjilan

Rade Popovic
Telefoni: 0280 20 289
Telefaksi: 0280 24 067

Kragujevc

Rr.9, "Lole Ribara"
Telefoni: 034 330-234; 330-784
kati 4-të

www.kpaonline.org

Mitrovicë

Zyra kryesore:
Shtabi Rajonal i UNMIK-ut (Jugo-
banka)
Telefoni: 028 30 136/7
Telefaksi: 028 30 139
Zyret e vizitorëve::
Pjesa Jugore: Rr. Mbretëresha Teuta
(përballë Jugobankës)
Pjesa Veriore: Ndërtesa e AKM-së,
Dhoma nr. 18, Kompleksi i Stacionit
Verior të UNMIK-ut

Nish

Rr. "Dusanov Bazar" (Dusanova)
Telefoni: 018 515-727; 515-728
kati 3-të, Zyra br. 308

Pejë

Zyra Kryesore: Rr. "Mbreteresha
Teuta", 153
Telefoni: 039 32 968
Telefaksi: 039 32 970
Zyra e vizitorëve: 54, Mosha Pijade

Prizren

Zyra Kryesore:
Shtabi Rajonal i UNMIK-ut
Tel/Fax: (029) 631-469
Tel: (038) 504604 ext. 8046/8024
Zyra e vizitorëve
Jeronim De Rada"/ "Zef Llush
Marku"/ "Metohijska" nr. 63
Tel: (029) 631-429

Podgoricë

Crnogorskih Serdara
Telefoni: 081 624 216

Prishtinë

Goleshit 2
Telefoni: 038 225 473
Telefaksi: 038 244 854

Shkup

Vinichka Street No. 10
(CDRIM-building), kati i parë
Telefoni: +389 71 886 564